



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË  
VERIUT



Në Bazë të nenit 22 paragrafi 7 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në seancën e 50-të, të mbajtur më datë 21 korrik 2021 morri

#### VENDIM

Procedura për lëndën 09 –3668/1 e datës 16.07.2019 NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm në lëndën me numër 09 –3668/1 të datës 16.07.2019, për arsye se sipas pohimeve nga denoncimi është vepruar sipas lëndës 12-436/1 të datës 22.01.2020.

Lënda me numër 09 –2827/1 të datës 23.05.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

#### Arsyetim

Lënda me numër 09 –3668/1 e datës 16.07.2019 është formuar në bazë të një parashtese nga Komuna ----- me të cilën kërkohet që Komisioni Shtetëror të merrë iniciativ për shkarkimin e drejtorëve të mëposhtëm ----- Drejtor në SHMK -----, ----- Drejtori i SHMDK -----, ----- drejtori i SHMTK ----- dhe ----- drejtori i SHF „-----.

Lidhur me pohimet e ngjashme, Komisioni Shtetëror veproi sipas lëndës me numër 12-436 / 1 të datës 22.01.2020, për të cilën u mor një vendim përfundimtar.

Duke vepruar në lidhje me lëndën konkrete, u konstatua se Kryetari i Komunës ----- më 25.12 dhe 26.12.2019 miratoi aktvendim të cilat janë ----- drejtor të shkollës së mesme -----, ----- Drejtori i SHMDK -----, ----- Drejtori i SHMTK----- dhe ----- Drejtori i SHF -----, a në deklaratën e Kryetarit të Komunës përcaktohet se pas Aktvendimit për revokimin e kompetencave nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me nr. 08-2133 / 1 të datës 13.02.2019 i skadoi afati për periudhën prej nëntë muajsh, Kryetari i Komunës ----- duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij të përcaktuara me ligj, konstatoi parregullsi në procedura për emërimin e drejtorëve të bërë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në një kohë kur ai po kryente detyrat e tij në emër të Kryetarit të Komunës -----, përmes së cilës miratoi Aktvendim duke i shpallur të pavlefshme vendimet për emërimin e drejtorëve të përmendur në disa shkolla -----.

Me këtë situatë faktike të përcaktuar, Komisioni Shtetëror konstaton se në rastin konkret situata e deklaruar në parashtesë është kapërcyer nr. 09 –3668/1 të datës 16.07.2019, përkatësisht personat për të cilët kërkohet shkarkimi nuk i kryejnë funksionet e përmendura.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Kryetar  
Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së  
Punoi: SM, bashkëpunëtor i lartë  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

